



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJTI POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 26/2018 (JR)  
Datë 25.10.2018

Vendim nr.7 (JR)  
Datë 05.04.2019



VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

<b>Ardian</b>	<b>Hajdari</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ina</b>	<b>Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana</b>	<b>Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol</b>	<b>Çomo</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Luan</b>	<b>Daci</b>	<b>Anëtare</b>

mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 05.04.2019, ditën e premte në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit **Elsion Sadiku**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Korçë.

**OBJEKT:** Shqyrtimi i vendimit nr.50, datë 27.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE** Neni 179/b pika 5 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenet 62, 63 vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar ligji 84/2016);

**TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi shkaqet e ankimit, pretendimet dhe kërkesat e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Ina Rama, dhe pasi e bisedoi atë,

**VËREN NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR SE:**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në vendimin nr. 50 datë 27.07.2018, ka arsyetuar se;

“ Trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës (neni D), ligjit nr. 84/2016 (kreu IV), lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Elsion Sadiku: Ka pasaktësi në deklarimin e burimeve financiare, deklarim të pamjaftueshëm të të ardhurave, si dhe ka burime financiare të paligjshme e, për rrjedhojë, ka burime financiare të ligjshme të pamjaftueshme për kryerjen e investimeve përkatëse. Nga analiza financiare rezultoi se për vitet 2011 dhe 2013 subjekti, me të ardhurat e fituara nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, huamarrjet, kreditë, dhuratat, nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve të deklaruara, si dhe për shpenzimet e kryera. Sa më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni DH), ligjit nr. 84/2016 (kreu V), lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, është i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni E), ligjit nr. 84/2016 (kreu VI), lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “me mangësi”, për arsye se ka treguar cilësi të papërshtatshme në punë dhe gjykim të dobët.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit:

a) Nga vlerësimi i secilit prej tri kriterëve,

- Nuk ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë, sepse ka pasaktësi në deklarimin e burimeve financiare, deklarim të pamjaftueshëm të të ardhurave, ka burime financiare të paligjshme, si dhe balancë financiare negative për vitet 2011 dhe 2013, duke bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë (neni 61/3 i ligjit nr. 84/2016);
- Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës (neni 59/b i ligjit nr. 84/2016);
- Është “me mangësi” në vlerësimin e aftësive profesionale (neni 44/b i ligjit nr. 84/2016);

b) Nga vlerësimi tërësor i kriterit të pasurisë dhe i aftësive profesionale ka cënuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë (neni 61/5 i ligjit nr. 84/2016)”.

2. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim trupi gjykues), pasi shqyrtoi ankimin sipas shkaqeve të paraqitura në të, si edhe pasi shqyrtoi të gjitha provat dhe aktet e administruara në këtë çështje nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në procesin e rivlerësimit, arriti në konkluzionin se Vendimi nr. 50 datë 27.07.2018 i Komisionit, është i drejtë dhe i mbështetur në fakte e provuara dhe në ligj pasi vlerëson se:

- I. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm, pasi nuk provoi bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe ka mungesë të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive. Trupi gjykues gjithashtu konstatoi se subjekti i rivlerësimit lidhur me kriterin e pasurisë ka bërë në mënyrë të vazhdueshme deklarime të pasakta në deklaratat periodike të pasurisë.

Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit që kanë të bëjnë me mënyrën e vlerësimit nga Komisioni të denoncimeve të marra nga publiku për subjektin Elsion Sadiku, trupi gjykues këto pretendime i gjen pjesërisht të pabazuara. Për denoncimin e bërë nga z.Adriatik Lapanji (si përfaqësues i z.Mahmut Mahmuti) trupi gjykues arrin në konkluzionin se me veprimet dhe mosveprimet e tij procedurale në kuadër të hetimit të



materialit kallzues nr.1751 datë 31.10.2017 të depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, subjekti i rivlerësimit ka cënuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

3. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, çmon se vendimi nr.50, datë 27.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, shumicë votash, në zbatim të nenit D pika 1, 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 61 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë:

**V E N D O S I :**

- Lënien në fuqi të vendimit nr.50, datë 27.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Elision Sadiku.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
- U shpall në Tiranë, sot më datë 05.04.2019.

**ANËTARE**

Albana Shtylla



**ANËTAR**

Luan Daci




**ANËTAR**

Sokol Çomo



**RELATORE**

Ina Rama



**KRYESUES**

Ardian Hajdari



[Shqip.com]